



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:111606  
Datë: 24.01.2025  
Numri i dokumentit: 06755230

ARJ.nr.141/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Delushe Halimi kryetare, Ragip Namani dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “A. K.” Shpk, me seli në P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ - vendimit të paditurës nr.01.3.2.2/8621 të datës 20.08.2020, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1166/22, të datës 05.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23 janar 2025, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi “A. K.” Shpk, me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1166/22, të datës 05.12.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1166/22, të datës 05.12.2023, është vendosur si në vijim: REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, “A. K.” Shpk me seli në P., e datës 22.02.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.1507/20 të datës 07.12.2021, VËRTETOHET.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.1166/22, të datës 05.12.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe shkeljes të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të ANULOHET Aktgjykimi

i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë K.DH.SH.II.nr.1166/22, të datës 05.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1507/20, të datës 07.12.2021, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/8621 të datës 20.08.2020, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “A. K.” shpk me seli në P., për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2020-110 të datës 10.07.2020 të lëshuar nga Sektori për Kontrolla Pas Importuese, si e pa bazë. Në arsyetimin e këtij vendimi ndër të tjera theksohet se: Sektori i Kontrollit pas Importues, pas kërkesës nga Zyra e Brendshme Doganore M., për klasifikim tarifor dhe përgjigjes së marr nga Sektori i Tarifës, ka nxjerr aktvendim për inkasim për paditësin për import të mallit “traktorë bujqësore të pyjeve” me rrota marka, 2 Ulëse, të deklaruar me kodin tarifor 8..., dhe pas përgjigjes së marr nga Sektori i Tarifës të datës 22.01.2020 për klasifikimin e mallit në fjalë, Sektori i Kontrollit Pas Importues ka ndryshuar të dhënat në Deklaratën Unike Doganore me aktvendimin e sektorit pas importues nr. 0..., të datës 10.07.2020, dhe e ka klasifikuar mallin në Kodin Tarifor 8..., me të cilin paditësi është obliguar që të paguaj TVSH në shumën prej 60,069.55€.

Kundër vendimit të lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës, paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin, A.nr.1507/20, të datës 07.12.2021, ka vendosur si në vijim: I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit “A. K.” Shpk, me seli në P., si e pabazuar. II. Mbetet në fuqi vendimi nr.01.3.2.2/8621 të datës 20.08.2020, i Doganës së Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje t'i kundërshtoj argumentet dhe konstatimet e dhëna në mendimin e klasifikimit tarifor të Sektorit të Tarifës nr. nr.0..., 06.04.2020 dhe 0..., 06.04.2020, se malli lëndor i zhdoganuar me DUD-in kontestues i përket kodit tarifor 8... Gjykata konstaton se në procedurën administrative është vërtetuar gjendja faktike ashtu që paraprakisht Sektori Pas importues-Dogana e Kosovës në bazë të mendimit mbi klasifikimin tarifor të Sektorit të Tarifës nr.0..., 06.04.2020, se malli lëndor i zhdoganuar me DUD-in kontestues duhet të ndryshohet dhe klasifikim i duhur është në kapitullin 87 respektivisht në numrin tarifor 8..., për mallin lëndor. Për më tej, është arsyetuar se për ti plotësuar kriteret e kodit tarifor 8..., të dizajnuar për të përdor si traktor me karakteristika

vijuese duhet të këtë një ulëse për vozitësin e jo për persona tjerë siç është malli lëndor, si dhe transmisioni i fuqisë në rrota të jetë përmes boshtit e jo me zingjir kriteret të cilat nuk plotësohen për mallin lëndor. Andaj, sipas sqarimeve të dhëna, kriteret e lartcekura dhe shënimeve sqaruese të nënndarjeve 87019011 deri 87019050 automjetet duhet të klasifikohen si ATV, mjet ndryshe nga traktorët bujqësore apo pyjor në nënndarjen 8701.

Kjo gjykatë vlerëson se e paditura në bazë të autorizimeve që ka me nenin 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike kur në bazë të Rregullave të Përgjithshme mbi Klasifikimin e Mallrave 1-6, Shënimeve Shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinar të Kapitullit 87, Shënimeve sqaruese për kodin konkret 8..., ka bërë ndryshimin e të dhënave në DUD-in kontestues, me të cilët është zhdoganuar malli me kodin tarifor në mënyrë jo të drejt. Ashtu që me aktvendimin nr. 03.1.1-2020-110 të datës 10.07.2020 ka përmirësuar numrin tarifor të deklaruar të mallit me DUD-in kontestues dhe ka vendosur kodin tarifor të ri, duke e obliguar paditësin të paguaj taksat doganore dhe Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, vendim ky i konfirmuar edhe nga Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës me aktvendimin kontestues. Ndërsa, paditësi nuk ka siguruar asnjë provë materiale nga eksportuesi i mallit të shteti eksportues për t'i konfirmuar pretendimet ankimore se malli i deklaruar me DUD-in kontestues është deklaruar drejt me kodin tarifor. Prandaj në këtë fazë të klasifikimit tarifor gjykata nuk gjen prova se paditësi ka ofruar provat gjegjësisht informatën detyruese tarifore nga shteti eksportues të përshtatshme me gjendjen faktike, për të vërtetuar se vërtet malli lëndor klasifikohet në kodin tarifor të deklaruar sipas DUD-it kontestues të cilën Deklaratë e ka ndryshuar Sektori i Kontrollës Pas Importuese, me aktvendimin nr. 03.1.1-2020-110 të datës 10.07.2020.

Lidhur me pretendimet ankimore të paditësit për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se të njëjtat nuk i ka aprovuar si të bazuara ngase paditësi për t'i vërtetuar pretendimet e veta në pajtim më dispozitat e nenit 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102, është dashur t'i provoj me argumente faktet që e mbështesin kërkesën e tij, mirëpo as në procedurën administrative e as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që t'i provoj pretendimet se vërtet malli lëndor i deklaruar me DUD-in kontestues, është deklaruar drejt në aspektin e klasifikimit tarifor të mallit lëndor, dhe se malli gjendja faktike e mallit lëndor i përgjigjet nr. tarifor të deklaruar nga paditësi. Në referim të nenit Neni 81.E par. 4. pika 4 dhe 5 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka theksuar se barra e të provuarit në procedurë bie mbi paditësin që në rastin konkret të dëshmojë me prova bindëse një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse sa i përket kodifikimit të mallit lëndor, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka shqyrtuar shënimin 2 të kapitullit 87 Mjetet e transportit të ndryshëm nga vagonët e hekurudhës ose tramvajit, pjesët dhe plotësuesit e tyre të Tarikut të Kosovës i cili është i aplikueshme në bazë të nenit 24 të KDA-së e cila parasheh se *“Për qëllimet e këtij kapitulli, “traktorët” do të thotë mjet transporti i konstruktuar kryesisht për tërheqjen ose shtytjen e një mjete tjetër transporti, pajisje apo ngarkesë, nëse ato përmbajnë ose jo mjete ndihmëse për transport, në lidhje me përdorimin kryesor të traktorit, veglave, farërave,*

*plehërove apo mallrave të tjerë*”. Prandaj në bazë të shënimeve të kapitullit 87 të Tarik-ut të Kosovës dhe gjendjes faktike të mallit lëndor ashtu siç është specifikuar në mendimin për klasifikim tarifor nr. 0., nr.36.04.2020 dhe 0. nr. 39/06.04.2020 malli lëndor nuk plotëson kritere për të klasifikuar nën numrin tarifore nr. 8., mirëpo duhet të klasifikohet ashtu siç ka përcaktuar Dogana e Kosovës, mjet ndryshe nga traktori bujqësor nën nr. tarifor 8... Në këtë kuptim gjykata pajtohet me qëndrimin juridik të paditurës pasi që në kontekst të argumenteve ligjore dhe provave të paraqitura në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka mundur me argumentuar një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura, andaj pretendimet e paditësit gjykata nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Andaj gjykata vlerëson se duke marrë parasysh provat, dhe konstatimet e lartcekura e paditura me të drejtë ka obliguar paditësin të paguaj taksën doganore dhe TVSH-në.

Lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se ka shqyrtuar bazën ligjore të cilën e ka aplikuar e paditura në vendimin kontestues, përkatësisht nenit 82 të KDA-së, ku përcaktohet se: *“Dogana sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të deklaruesit e rishqyrton deklaratën pas lirimt të mallit. Dogana, pasi ta ketë lejuar lirin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky kontroll mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij ose të çdo personi tjetër në posedimin e të cilit janë dokumentet e lartshënuara për qëllime tregtie. Dogana, po ashtu mund të, kontrollojë edhe mallrat kur paraqitja e tyre është ende e mundur, Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se, dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta, apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerr masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”,* andaj mbi këtë bazë ka vlerësuar se e paditura ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të lartcekura të KDA-së, kur e ka obliguar paditësin që të paguaj TVSH-në.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi kontestues i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa në mungesë të fakteve që të vërtetohet se paditësi ka deklaruar drejt mallin lëndor në bazë të procedurave doganore në fuqi gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit për arsye se paditësi nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative. Në këtë kuptim, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 81.F par.1, të Ligjit nr. 04-L-102, *“Tatimpaguesi do të bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj”,* si dhe nenit 7 par.1 dhe 3 të LPK-së.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, andaj duke bazuar në të dhënat e

lantcekura, dhe në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhomat e shkallës së dytë, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së, neni 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe neni 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Në arsyetim të aktgjykimit të saj ndër të tjera thekson se: Kolegji vlerëson se në bazë të nenin 82 të KDA-së, si dhe në bazë të mendimit nga Sektori i Tarifës, ka rezultuar se subjekti në fjalë nuk ka deklaruar saktë Kodin Tarifore, në të gjitha importet ku janë të liruara nga obligimet doganore dhe obligimet e TVSh-së, ashtu që në gjashtë importet e para subjekti në fjalë është dashur të paguaj 10% të vlerës së mallit për taksën e doganës si dhe 18% të taksës së TVSh-së, të cilat i takojnë (mjeti motorik Marka-Maverick Sport DPS kodi tarifor 8...) si dhe për 17 importe të cekura në pjesën e dytë është dashur të paguaj taksën e TVSh-së, të cilat i takojnë numrit tarifor (mjeti motorik Marka-20 Outlander BRP kodi tarifor 8...).

Lidhur me pretendimet ankimore të paditësit, kolegji i kësaj gjykate ka theksuar se të njëjtat i ka shqyrtuar në baza ligjore dhe i ka refuzuar si të paqëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, me arsyetimin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative të LKA-së, apo të LPK-së, ligj i zbatueshëm, e po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, sipas çështjes në shqyrtim. Tutje ka theksuar se, e paditura në bazë të autorizimeve që ka me nenin 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike kur në bazë të Rregullave të Përgjithshme mbi Klasifikimin e Mallrave 1-6, Shënimeve Shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar të Kapitullit 87, Shënimeve Sqaruese për Kodin konkret 8.. sipas shënimeve sqaruese të nomenklaturës së kombinuar ka bërë ndryshimin e të dhënave në DUD-in kontestues me të cilët është zhdoganuar malli me kodin tarifor në mënyrë jo të drejtë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes si më lartë, vlerësimit të pretendimeve si në kërkesë, ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe të shkallës së parë si dhe shkresave tjera të lëndës, vlerëson se dhomat e shkallës së dytë kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës Komerciale por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga çka rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pa bazuar të kërkesëpadsisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, nga gjykatat e instancës më të ulët, ka rezultuar se vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/8621 të datës 20.08.2020, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “A. K.” shpk me seli në P., për rishqyrtimin e aktvendimit nr.03.1.1-2020-110 të datës 10.07.2020 të lëshuar nga Sektori për Kontrolla Pas Importuese, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë konstatuar se e paditura sipas autorizimeve ligjore nga neni 82 të KDAK-së, ka nxjerr aktvendimin nr. 03.1.1-2020-110 të datës 10.07.2020, për inkasimin e paditësit për import të mallit “traktorë bujqësore të pyjeve” me rrota marka, 2 ulëse, duke e klasifikuar të njëjtin në Kodin Tarifor 8..., dhe duke e obliguar paditësin që të paguaj TVSH, në shumën prej 60,069.55€, mall ky i deklaruar nga paditësi sipas Deklaratës Unike Doganore, me kodin tarifor 8..., kod ky jo i drejtë për zhdoganimin e mallrave të eksportuesit nga shteti eksportues.

Pretendimet e paditësit, të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale dhe ndryshimin e kodit tarifor, ku ndër të tjera ka theksuar se: e paditura ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore nga neni 82.3, neni 219.3, neni 72.b, 265.1 (a, b, c), të KDAK-së, ndërsa ndryshimi i kodit tarifor nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, kjo ngase kodi tarifor në DUD-in kontestues është paraqitur në mënyrë të saktë dhe të drejtë nga paditësi, ngase malli doganor i përgjigjet emërtimit tregtar dhe numrit tarifor, sipas karakteristikave të atij malli dhe dokumenteve përcjellëse që kanë të bëjnë me homologimin e tipit të këtij mjeti dhe COC (deklaratës së konformitetit), kod ky i konfirmuar në bazë të Rregullores së BE-së nr.167/2013 dhe nr.2018/830..., kolegji i Gjykatës Supreme, i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzoi në tërësi si të pabazuara, ngase e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë. Kolegji vlerëson se e paditura Dogana e Kosovës, në mbështetje të nenit 18 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, ka autorizim ligjor të lëshoj informacion të detyrueshëm tarifor. Në rastin konkret, Sektori i Tarifës me kërkesë të ZBD Merdare, ka nxjerr Mendim për Klasifikim Tarifor nr.0..., 06.04.2020, të datës 22.01.2020, për mallin lëndor “traktorë bujqësore të pyjeve”, me rrota marka, 2 ulëse, duke bërë klasifikimin tarifor nga kodi i deklaruar në DUD-in kontestues 8..., në kodin 8..., sipas karakteristikave dhe përshkrimit të duhur të deklarimit të mallit, bazuar në TARIK.

Andaj, edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, paditësi as pranë organit të administratës dhe as pranë gjykatave të instancave më të ulëta, nuk ka arritur që të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar me vendimin kontestues, ndërsa barra e provave për ta dëshmuar të kundërtën e Mendimit për Klasifikim Tarifor, në këtë rast bie mbi

paditësin, ashtu siç parashihet me nenin 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për ATK.

Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë, nuk rezulton se është i përfshirë as me shkelje procedurale të dispozitave nga neni 182 par. 2, pika (n), ashtu siç pretendon paditësi në kërkesë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykatat e instancave më të ulëta kanë vepruar në baza ligjore me vendosjen e çështjes, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, i vërtetuar në procedurë ankimore nga gjykata e shkallës së dytë. Nga gjendja si më lartë rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë të drejtë kanë bërë aplikimin e dispozitave të LKA, LPK, KDAK-së. Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të qartë të kuptueshëm dhe përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, dhe me të drejtë kanë vlerësuar se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit.

Nga se u theksua si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË  
ARJ.nr.141/2024, më datë 23 janar 2025

B. Profesionale  
Zanë Buçinca

Kryetare e Kolegjit  
Delushe Halimi